REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr.438 Prot Prrenjas më 09/02/2026

PROJEKT-UDHËZIM

Nr. 01, datë 09/02/2026

PËR
"PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR MËNYRËN E PARAQITJES SË APLIKIMIT DHE PROCEDURËN ADMINISTRATIVE PËR NJOHJEN SI POSEDUES JOPRONAR"

Në mbështetje të ligjit nr. 20/2025 "Për paketën e maleve"; ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; si dhe udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territorin e bashkive",

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitjes së aplikimit/kërkesës dhe procedurën e brendshme administrative që ndiqet nga bashkia për njohjen e poseduesve jopronarë në zonat e shpallura si zona zhvillimi.
2. Ky udhëzim synon të ofrojë udhëzime të qarta dhe të sakta për të gjithë subjektet aplikuese në procesin e paraqitjes së kërkesës për njohjen e tyre si posedues jopronar.
3. Bashkia Prrenjas ka si objektiv kryerjen e procedurave administrative për njohjen e subjekteve kërkuese si posedues jopronar, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe të këtij udhëzimi, duke u udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, transparencës, objektivitetit dhe eficencës.

II. PARAQITJA E KËRKESËS

1. Për çdo zonë zhvillimi të shpallur ngrihet grupi teknik i punës, përbërja dhe afati i veprimtarisë së të cilit miratohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Grupi i punës ndjek të gjithë procesin administrativ, nga paraqitja e kërkesës deri në njohjen e subjektit kërkues si "posedues jopronar".
2. Grupi i punës ngrihet në varësi të rrethanave të posaçme të secilës zonë të aplikuar.
3. Subjekti paraqet kërkesën e argumentuar me shkrim nëpërmjet aplikimit online, në zërin e dedikuar për këtë qëllim në portalin e-Albania. Kërkesa shoqërohet me plan rilevimi të sipërfaqes së poseduar, të hartuar nga një ekspert gjeodet i licencuar.
4. Kërkesa shoqërohet me një ose më shumë nga dokumentet e mëposhtme:
   a. dokumentacion tatimor që vërteton ushtrimin e aktivitetit ekonomik mbi pasurinë;
   b. fatura të shërbimeve të lidhura me pasurinë, si: energjia elektrike, uji etj.;

c. deklarata ose dëshmi të banorëve dhe autoriteteve vendore që vërtetojnë përdorimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë të pasurisë për të paktën 10 (dhjetë) vjet;
d. fotografi, ortofoto ose prova të tjera materiale që vërtetojnë posedimin;
e. çdo dokument tjetër që provon lidhjen e subjektit aplikues me pasurinë.

5. Mungesa e dokumentacionit provues nuk përbën shkak për refuzim, rrëzim të kërkesës apo pezullim të procedurës administrative për njohjen e subjektit kërkues si "posedues jopronar".

III. PROCEDURAT E VERIFIKIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESËS

1. Pas regjistrimit të kërkesës, grupi i punës kryen verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në të gjithë elementët e tij.
2. Në rast të mungesës së provave shkresore, grupi i punës realizon verifikimin në terren, përmes inspektimeve dhe marrjes së deklaratave/dëshmive nga banorët e zonës, duke mbajtur procesverbal për këtë qëllim.
3. Procesverbali i hartuar nga grupi i punës përfshin të dhëna mbi:
a.përputhshmërinë e sipërfaqes së rilevuar me gjendjen faktike;
b. posedimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë të pasurisë për të paktën 10 (dhjetë) vjet;
c.mungesën e pretendimeve nga të tretët mbi sipërfaqen e kërkuar;
d. informacion mbi gjendjen juridike të pasurisë, në bashkëpunim me ASHK dhe ATP;
e. informacion mbi kriteret lidhur me pronën.
4. Nëse konstatohet se nuk përmbushen një ose disa nga kriteret sipas shkronjës "c" të nenit 3 dhe nenit 8 të ligjit nr. 20/2025, bashkia njofton subjektin kërkues për pamundësinë e vijimit të procedurës për njohjen si "posedues jopronar".
5. Nëse vetëm një pjesë e sipërfaqes së aplikuar përmbush kushtet ligjore, kërkohet dakordësia e subjektit kërkues për vijimin e procedurës për këtë sipërfaqe. Në mungesë të përgjigjes brenda 30 (tridhjetë) ditëve, prezumohet refuzimi.
6. Afishimi publik shoqërohet me listën e subjekteve aplikuese, sipërfaqet respektive, përshkrimin e vendndodhjes dhe planin e rilevimit.
7. Në rast paraqitjeje pretendimesh nga të tretët gjatë afishimit publik, bashkia njofton subjektin kërkues për pamundësinë e vijimit të procedurës, sipas rasteve të parashikuara.

IV. MIRATIMI I KËRKESËS DHE NJOHJA E POSEDUESIT JOPRONAR

1. Pas përfundimit të afatit të njoftimit publik, grupi i punës:
a. harton listën përfundimtare të subjekteve aplikuese dhe planet e rilevimit përkatëse;
b. paraqet dokumentacionin për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda 30 (tridhjetë) ditëve;
c. Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton listën brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e dokumentacionit;
d. pas miratimit, pasqyron poseduesin jopronar në kartelën përkatëse të pasurisë.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Bashkisë.
2. Ky udhëzim publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Prrenjas.

KRYETARI I BASHKISË

NURI BELBA